



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 11.10.2024

Nr. Prot. 2948

Lënda: Mbi votimin elektronik

Drejtuar: **Partia Socialiste e Shqipërisë**
Rruga Çamëria, Tiranë 1000

Partia Demokratike e Shqipërisë
Bulevardi Zhan D'Ark, 11, Tiranë

Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet
Pas Ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tiranë

Partia e Lirisë
Rruga Sami Frashëri, Godina 20/10, Tiranë

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë
Rruga Skënderbej (Blloku i Ambasadave),
Tiranë

Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë
Rruga Pjeter Budi 6, Tiranë

Partia Republikane e Shqipërisë
Rruga Abdi Toptani 2-10, Tiranë

Partia Lëvizja e Legalitetit
Rruga Frederik Shiroka, Tiranë

Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar
Rruga Andon Zako Çajupi, Tiranë

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
Bulevardi Bajram Curri, Nr.32, Tiranë



Të nderuar,

Në vijim të komunikimeve të mëparshme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me ju mbi mundësinë e zhvillimit të votimit elektronik në 5 qarqe, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2025, më lejoni t'ju sjellë në vëmendje se kjo mënyrë votimi në këtë numër qarqesh nuk mund të zhvillohet. Periudha nga sot deri në datën 20 Prill 2024 që është data e parë e mundshme e zhvillimit të zgjedhjeve në fjalë, apo deri në datën 11 Maj 2024 që është data e fundit e mundshme për zhvillimin e zgjedhjeve të vitit 2025, është e pamjaftueshme për përgatitjen e gjithë elementëve teknik dhe njerëzor për zhvillimin e këtij lloji votimi në këtë numër qarqesh.

Gjithsesi duke vlerësuar interesin dhe dobinë për shtrirjen graduale të votimit elektronik, KQZ për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2025, propozon zhvillimin e kësaj mënyre votimi vetëm në qarkun e Elbasanit dhe në atë të Durrësit.

Në qarkun e Elbasanit u zhvillua votimi elektronik për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023 në shumicën e qendrave të votimit të këtij qarku, të cilat i përkasin bashkisë Elbasan. Ndaj nëse nga ana juaj vlerësohet me dobi dhe interes shtrirja e votimit elektronik, është me kuptim që më së pari ai të shtrihet në ato njësi zgjedhore ku një pjesë e votuesve të kësaj njësie e kanë një eksperiencë të mëparshme me këtë lloj votimi.

Rekomandoj zhvillimin e votimit elektronik në qarkun e Durrësit, për lehtësitë logjistike dhe njerëzore që ofron ky qark krahasuar me qarqe të tjerë të vendit. Durrësi për shkak të terrenit gjeografik, infrastrukturës rrugore dhe asaj tjetër, distancës me Tiranën (KQZ-në), mundëson një përgjigje më të mirë nga ana e këtij institucioni për përgatitjen, zhvillimin dhe administrimin e votimit elektronik.

Nga ana tjetër ky lloj votimi kërkon angazhimin e një numri të madh njerëzish në terren. Praktika e identifikimit elektronik ka treguar se për qarkun e Durrësit në përgjithësi rekrutimi i personelit të posaçëm për këto procese administruese zgjedhore është më pak sfidues se në shumë qarqe të tjerë. Numri dhe natyra e punës që kryen personeli që do të angazhohet me votimin elektronik është thujse e njëjtë me atë të identifikimit elektronik.

KQZ vlerëson të domosdoshëm një mendim të partive politike në lidhje me këtë propozim.

Ndaj jeni të lutur ta përcillni atë pranë KQZ, jo më vonë se data 19 Tetor 2024.



KQZ është në dispozicion për çdo sqarim të mëtejshëm dhe/ose të zhvillimit të një takimi konsultues në lidhje me këtë çështje, përpara datës 19 Tetor 2024.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

Me respekt

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

